



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 2527 Prot.

Elbasan, më 12 06.2025

LËNDA: Kërkesë për marrje masash për bllokim të përkohshëm të qarkullimit rrugor për qëllime pastrimi

DREJTUAR:

DREJTORIA VENDORE E POLICISË
Lagjja "5 Maji", Rruga "Koço Brisku", Elbasan

Për dijeni:

- Policia Bashkiake
 - Drejtoria e Monitorimit
 - A.SH.P Urbane
 - A.SH.R Rurale
- Këtu

I/e nderuar/Znj. Drejtor/e,

Në zbatim të:

- Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar,
- Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,
- Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar,

Ju informojmë se Bashkia Elbasan ka planifikuar të realizojë procesin e larjes dhe pastrimit të disa segmenteve rrugore me mjete të specializuara në datat dhe zonat si më poshtë:

1. Data 21.06.2025

- Rruga "Rinia"
- Blv. "Aqif Pasha"

2. Data 22.06.2025

- Rruga "28 Nëntori"
- Rruga "Ismail Zyma" (pranë spitalit)

3. Data 28.06.2025

- Rruga "Qemal Stafa" (nga kryqëzimi i luleve deri në unazë)
- Rruga "Thoma Kalefi" (nga Bashkia deri në kryqëzimin e Cërrikut)

*Punimet do të zhvillohen nga ora 06:00 deri rreth orës 18:00, në varësi të përfundimit të pastrimeve. **Për mbarëvajtjen e procesit, kërkojmë marrjen e masave për:***

- Ndalimin e përkohshëm të qarkullimit rrugor në segmentet përkatëse,
- Ndërgjegjësimin e drejtuesve të mjeteve për ndalimin e parkimit dhe lëvizjes,
- Sigurimin e rendit dhe asistencës në terren gjatë procesit.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj institucional.

